

Drejtoria e Pergjithshme e Standardizimit ka nënshkruar Marrëveshje Bashkëpunimi me disa “aktorë” shumë të rëndësishëm të ekonomisë shqiptare si me *“Alb-Konfindustria”*, me *Dhomën e Tregtisë dhe Industrisë* në Tiranë dhe me *Agjensinë Rajonale të Zhvillimit* në Korçë.

Marrëveshjet shprehin qartë vullnetin e institucioneve (infrastrukturës së cilësisë dhe atyreve që merren me zhvillimin ekonomik) për të bashkëpunuar në fushën e standardeve, duke i dhënë përparësi përdorimit të standardeve europiane në fuqi sidomos nga industritë prodhuese dhe shërbimeve, duke promovuar rëndësinë, rolin dhe përfitimet që rrjedhin nga një bashkëpunim i ngushtë midis tyre si palë të interesuara për zhvillimet teknologjike në fushën e sigurisë dhe cilësisë së produkteve e shërbimeve.

Marrëveshjet do të kenë ndikimin e tyre shumë pozitiv për industritë në veçanti dhe biznesin shqiptar në përgjithësi në kushtet kur Shqipëria ka nënshkruar MSA me Bashkimin Europian dhe si rrjedhim konkurrenca në tregun e brendshëm dhe eksporte ndërmjet prodhimeve dhe shërbimeve vendore me të huajat është mjaft e fortë. Zbatimi i marrëveshjeve në fjalë shkon pikërisht në drejtim të rritjes së cilësisë së produkteve vendase, në marrëdhëniet tregtare rajonale, në rritjen e sigurisë së jetës së punonjësve në punë si dhe do t'i shërbejë sipërmarrësve vendas dhe atyre të huaj, që ushtrojnë veprimtari ekonomike në vendin tonë të zbatojnë ligjshmërinë, rregullat dhe standardet e mbrojtjes në punë si dhe standarde të tjera, kushte të domosdoshme për zhvillimin ekonomik afatgjatë e të qëndrueshëm te vendit.

Në terma me konkrete këto Marrëveshje do t'i sigurojnë biznesit vendas standardet europiane e ndërkombetare në fuqi për fushat e ndryshme për të cilat biznesi ynë ka aq shumë nevojë si p.sh.

- standarde të industrisë prodhuese;
- standarde të fushës së ndërtimit;
- standarde të fushës së prodhimeve e përpunimeve bujqësore;
- standarde të sigurisë dhe mbrojtjes në punë, ku mund të përmendim ato për mbrojtjen nga zjarri, për masat që merren ndaj djegshmërisë dhe sjelljen ndaj zjarrit, materialeve dhe produkteve, mbrojtjen nga eksplozioni, mbrojtjen nga mallrat e rrezikshme, standardet për pajisjet mbrojtëse, veshjet mbrojtëse, pajisjet mbrojtëse të kokës etj etj, një numër i pafund standardesh në ndihmë të punonjësve dhe në ndihmë të sipërmarrësve për të plotësuar legjislacionin aktual.